

J E T A S H K E N C O R E

EKSPEDITAT LEKSIKOLOGJIKE TË VITIT 1964

Në periudhën 1-30 korrik dhe 1-15 shtator 1964 u organizuan nga sektori i leksikologjisë e i leksikografisë, i Institutit të Historisë e Gjuhësisë në përfutur me planin e tij të punës kërkimore shkencore, 11 ekspedita leksikologjike 15-ditore në rrethet Durrës, Tiranë, Peshkopi, Kukës e Krujë. Në këto ekspedita u aktivizuan edhe 34 studentë të Fakultetit Histori-Filogji, si dhe 7 bashkëpunorë të jashtëm të sektorit. Ekspeditat u drejtuan nga bashkëpunorët shkencorë M. Kazadej, P. Daka, J. Thomaj, M. Samaraj, Xh. Lloshi dhe P. Haxhillazi. Këto ekspedita eksploruan nga pikëpamja leksikologjike 143 pika (fshatra ose kooperative bujqësore të bashkuara) dhe grumbulluan rreth 14.500 fjalë e shprehje me interes shkencor si dhe një numur toponimesh.

Sipas udhëzimeve të sektorit, vendja në këto ekspedita u përqendrua më tepër në sferat e leksikut abstrakt dhe të frazeologjisë, pa lënë pas dore, padyshim, sferat e tjera. Fonedit i fjalëve abstrakte dhe frazeologjia, si më të vështirë për t'u kapur brenda kohës së shkurtër që qëndron mbledhësi në një pikë, janë mbledhur nga ekspeditat e gjertanishme, për këtë shkak, më pak se ai i sferave të tjera. Duke patur këtë parasysh ekspeditat e vitit 1964 bënë një hap më përpara. U grumbulluan një sasi e kënaqëshme fjalësh të leksikut abstrakt dhe shprehje popullore.

Nga një studim paraprak i materialeve leksiko-frazeologjike të mbledhura nga ekspeditat e vitit 1964 del se nga pikëpamja e cilësisë së tyre ato janë më të mira se materialet e mbledhura nga ekspeditat e mëparshme. Kjo spjegohet me eksperiencën e fituar, si në përgatitjen e ekspeditave, ashtu edhe në përmirësimin e metodave të mbledhjes dhe të regjistrimit. Kësaj i ka shërbyer gjithashtu edhe skedimi në

vend i materialeve të mbledhura, gjë që jep mundësi për verifikimin dhe plotësimin e këtyre materialeve dhe rrit saktësinë e sigurinë e tyre.

Numri i pikave (fshatave ose kooperativeve të bashkuara bujqësore) të eksploruara nga ekspeditat e vitit 1964, në krahasim me kohën është i mjaftueshëm. Po shkohet gjithënjë e më përpara drejt zbatimit të udhëzimit të sektorit që, në përfutur me kushtet konkrete të terrenit, mbledhësit e leksikut të qëndrojnë për një kohë sa më të gjatë në pikat që marrin për eksplorim, me qëllim që: të kenë mundësi e kohë për të punuar për grumbullimin e leksikut abstrakt, i cili, siç dihet, kërkon një kohë më të gjatë dhe kushte e rrethana të caktuara (bisedë të lirë nëpër mbledhje, dasma, festa etj.).

Me pikat e eksploruara nga ekspeditat e vitit 1964 u mbyllën rrethet Durrës, Krujë, Kukës, Peshkopi dhe në pjesën më të madhe rrethi i Tiranës. Kështu, pothuaj, përfundoi eksplorimi i Shqipërisë së mesme, lindore dhe veri-lindore. Mbeten për vitet e ardhme rrethet Mat, Mirditë, Tropojë, Pukë, Lezhë e Shkodër.

Ekspeditat e vitit 1964 i dhanë kartotekës së leksikut të shqipes një fond të konsiderueshëm fjalësh e shprehjesh me interes të gjuhës së gjallë të popullit, një pjesë e mirë e të cilave nuk pasqyrohen në letërsinë e shkruar dhe ndër fjalorët e gjertanishëm.

Një ndihmë të çmuar u kanë dhënë ekspeditave tona organet e partisë e të pushtetit në rrethe, lokalitete, e fshatra, seksionet e arësimit, kryesitë e kooperativeve bujqësore si edhe vetë fshatarët, të cilët kanë qenë të përtuar për të dhënë të gjitha spjegimet e nevojshme lidhur me materialin gjuhësor të mbledhur nga ekipet tona.

J. Th.

EKSPEDITAT DIALEKTOLOGJIKE TË VITIT 1964

Vitin e kaluar ka vijuar gjurmimi i të folmeve të truallit të Shqipërisë e i mbledhjes së materialeve dialektore me ekspedita në vend në krahina të ndryshme. Krahinat e gjurmuara kanë qenë si në veri, ashtu edhe në Shqipëri të mesme e jugore.

Për mbledhjen e materialit për një monografi për të folmen e Mirditës, janë bërë ekspedita në 5 pika të tjera të kësaj zone e të zonave fqinje me te, e pikërisht në Fang e Munaz të Rubikut, në Laç të Vaut të Dejës, në Kaçinar e poashtu në Thirrë të Fanit, rrethi i Kukësit. Në rrethine Shkodrës është bërë një ekspeditë në

krahinën e Anës së Malit. Në rrethin e Tiranës janë mbledhur materiale në Sauqet, Mënik e Mëzez dhe në Petrelë e Mesjeta. Në jugë janë bërë ekspedita në rrethin e Vlorës në krahinën e Mesaplikut, në fshatrat Tërbaç e Ramicë, këtej e përtej lumit të Shushicës; në Leskovik e Radanj të Leskovikut, dhe, së fundi, në Konispol e Mursi.

Materialet dialektore të këtyre 17 vendbanimeve kanë shtuar fondet e kartotekës së dialektologjisë e kanë shtrirë më tej njohjen e të folmeve të gjuhës sonë.

M. D.

ILO MITKË QAFËZEZI
5-XI-1889 — 16-IV-1964

Pak muaj para jubileumit të 75-vjetorit të lindjes së tij, vitin e kaluar u nda prej nesh lavruesi i njohur i studimeve shqiptare, gjurmuesi dhe studjuesi i palodhur i historisë kulturore të popullit tonë, Ilo Mitkë Qafëzezi. Jeta dhe vepra e tij kanë qenë një shembëll pune entuziaste e vetmohuese, në të mirë të kulturës shqiptare. Për rreth 60 vjet, që nga mosha ende e njomë gjer në ditët e fundit, pa u vënë poshtë as nga fatkeqësia e madhe fizike që e goditi njëzet vjet më parë, ai s'reshiti së punuari në fusha të ndryshme për lulëzimin e kulturës sonë, për arësimin e popullit tonë dhe përhapjen e njohurive shkencore në masat e tij, e sidomos për hulumtimin, popullarizimin dhe studimin e vlerave historike e kulturore të vendit, për ndriçimin e së kaluarës së tij.

Ilo Mitkë Qafëzezi s'pati mundësi të marrë një arësim të rregulltë, se, pas disa vjet shkollë fillore, ai u detyrua, si shumë bashkëqytetarë të tij, që në moshë të vogël, të marrë rrugën e mërgimit dhe të punojë për të fituar mjetet e jetesës si çirak, punëtor fabrike etj. në Rumani (1902-1906, 1915-1924) dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (1909-1919). Po, i frymëzuar nga etja e madhe për dituri dhe nga shkëndijat e patriotizmit që i kishte hedhur në zemër mësuasi i tij i shkollës shqipe, Nuçi Naçi, punoi me pasion e ngulm për të plotësuar e zgjeruar vazhdimisht njohuritë duke arritur me entuziazmin e vullnetin e tij të paepur të fitojë një kulturë të mirë. Njëkohësisht, që në vitet e parë të mërgimit, ai nisi veprimtarinë e tij letrare e studjuese duke zënë të interesohet për gjithëshka që kishte të bënte me folklorin, letërsinë, kulturën e historisë e kulturën e popullit tonë e duke marrë pendën në dorë për të kontribuar në ndriçimin e bashkëatdhetarëve të tij. Nisi të hartojë vjersha patriotike e të përpunojë anekdota popullore. Më 1903 botoheshin në revistën «Albania» të Londonit dy vjershat e para të tia, më 1905 në revistën humoristike rumune «Veselia» të Bukureshtit disa anekdota shqiptare të përpunuara rumanisht dhe më 1910 në Selanik një vëllim anekdotash popullore të vëna në vjershë «Rrësku arbëror». Bashkëpunimi i Ilo Mitkë Qafëzezi në gazetat e revistat shqipe nisi të bëhet më pas i dëndur. Më 1919 ai qe iniciatori kryesor i botimit të organit të Kolonisë shqiptare të Bukureshtit, i gazetës «Shqipëria e Re», një nga fletoret më jetëgjata dhe të rëndësishme të shtypit shqiptar, të cilën e drejtoi në vitin e parë. Duke ndërjerë nevojën e librave shqipe për masat e gjera të popullit, ai i vihete përkthimit, përshtatjes e hartimit, në një gjuhë popullore plot kolorit, të veprave të ndryshme letrare e shkencore-popullore. Veprimtaria e tij botuese është veçanërisht e gjallë më 1920-1923, kur ai boton shqipërimin e një drame të Oscar Wilde, të një pjese të Kuranit, të një historie të Napoleon Bonapartit, të jetës së Kristofor Kolombos, dhe një «Histori të Ali Pashë Tepelenës», sipas historianit grek Aravantino (1917,1923). Veprimtaria e tij letrare e shkencore-popullore mori një hov të ri pas vitit 1924, kur u ktheje në atdhe dhe hyri në arësim, ku punoi për 20 vjet si mësues e si drejtor shkollë. Shkruan shumë nëpër gazetë e revista mbi tema historike e anekdota popullore, boton vepra letrare si poemën legjendare «Leka i Math», disa broshura vulgarizimi të njohurive shkencore mbi sëmundje të ndryshme, si sifilizi, tuberkulozi etj., vepra historike si «Historia e Lekës së Math» (1929) etj.

Aty nga viti 1935 në veprimtarinë e këtij studjuesi të palodhur vihete re një fazë e re, mund të thomi kërkimore: gjurmimi gjithënjë e më sistematik i dokumentave e i monumentave kulturore e historike të vendit tonë ze një vend gjithnjë e më të madh. Gjatë verës ai shetit qytet më qytet e fshat më fshat për të zbuluar, përshkruar e studjuar dëshmitë e së kaluarës së popullit tonë, dorëshkrime, mbishkrime, piktura etj., jep herë pas here kumtime në shtyp për gjetjet e tia, shpëton nga zhdukja ose hedh në qarkullim shkencor materiale me interes për historinë e kulturës sonë, gjithë duke vijuar të shkruajë artikuj të shumtë mbi ngjarje e figura historike të vendit tonë. Përfundime me vlerë për shkencën tonë kanë pasur kërkimet e tij për historinë e kulturës sonë

në shekullin e XVIII, sidomos të pellgut të Korçës. Ai botoi artikuj e studime mbi Kavaliotin, Dhanil Haxhinë, Kostë Beratin, Naum Veqilharxhin, i bëri një botim të ri fjalorit të Kavaliotit, shkroi mbi dorëshkrime të letërsisë shqipe me shkronja arabe, mbi piktorë shqiptarë të shekullit XVIII, mbishkrimet e kisha-ve të Voskopojës etj. Më 1936 bashkë me komedinë «Dhaskal Gjoka» ai botoi një «Kontribut në historinë e pedagogjisë dhe kulturës në Shqipëri në qind-vjetet XVII, XVIII, XIX (1637-1902)» f. 82-168, ku janë paraqitur të dhëna me interes për historinë e shkollës në Shqipëri.

Më 1945 Ilo Mitkë Qafëzezi u godit nga një fatkeqësi e rëndë: humbi të parët. Po me gjithë atë ai nuk e ndërpreu veprimtarinë e tij prej studjuesi. Edhe në këtë gjendje të rëndë, ai gjeti mënyrën si të punojë, dhe, në kushtet që iu krijuan nga Pushteti Popullor, mundi të bëjë një punë të frytëshme shkencore. Në këto 20 vjet ai përpunoi materialet e grumbulluara më parë ose plotësoi në formë studimesh e monografish më të plota punimet e tij të mëparëshme.

Ilo Mitkë Qafëzezi la në dorëshkrim një numur të madh punimesh e materialesh mbi tema e figura të historisë e të historisë së kulturës sonë. Ndër ta përmëndim punimet e materialet mbi shumë figura të Rilindjes sonë, si Anastas Kulluriotin, Thimi Krein, Thimi Mitkon, Nikolla Naçon, Nuçi Naçin, Themistokli Gërmenjin, e ato mbi lëvizjen mendore të Voskopojës e figura të jetës kulturore të vendit tonë në shekullin XVIII, si Theodor Kavalioti, Dhanil Haxhiu, Kostë Berati etj.

Shkenca shqiptare i detyron Ilo Mitkë Qafëzezin zbulimin ose të vënët në dukje të mjaft dokumentave e monumenteve letrare e historike, siedhe mjaft punime me interes. Mjafton të përmëndim dorëshkrimet e Kavaliotit kopje të teksteve të logjikës, fizikës, metafizikës, mjaft shkrime autografe të Danilit, Theodor Haxhifilipit, një kopje të «Myhtarname» të Shahin Frashërit, shkrime të Kostë Cepit. Prej tij u bë gjerësisht i njohur dhe pjesërisht u botua dorëshkrimi i Kostë Beratit, i përshkruar së pari shkurtazi nga S. Koleja në një broshurë mbi veprimtarinë e Bibliotekës Kombëtare, u botuan materiale e studime me vlerë për historinë e kulturës sonë. Rezultate me rëndësi u arritën sidomos në ndriçimin e historisë së Voskopojës e të trevës së Korçës në shekujt XVII-XIX, në mënyrë të veçantë të jetës ekonomike e kulturore.

Veprimtaria e Ilo Mitkë Qafëzezit në letërsinë e në shkencat filologjike ka qenë e gjerë dhe e ndryshme. Ai dha një kontribut në zhvillimin e letërsisë fëminore me fabulat, anekdotat e tregimet për fëmijë që botoi në organe të ndryshme të shtypit të kohës. Ai punoi mjaft në fushën e folklorit, në mbledhjen dhe botimin e këngëve, prallave, po sidomos të anekdotave popullore. Botimin e dytë të Historisë së Ali Pashë Tepelenës ai e shoqëroi me një numër këngësh popullore. U përkujdes në mënyrë të veçantë për prozën satirike popullore. Sadoqë jo të riprodhuara me besnikërinë e nevojëshme, zakonisht të stilizuara, herë herë të përpunuara, në një pjesë edhe në vjershë, tregimet satirike që mbledhi e pjesërisht botoi ai, na japin të paktën tematikën e përmbajtjen e një pjese me interes të prozës sonë popullore, që ka qenë lënë pak si në harresë. Në «Rrëskun Arbëror» (1910,1923) ai dha të përpunuara në vjershë 70 anekdota shqiptare. Në vitet 1925-1940 ai botoi në prozë në gazeta të ndryshme shumë tregime të tjera satirike popullore me tituj si «Meselerat e vatrës shqiptare», «Anekdotat shqiptare», «Shakatë shqiptare» etj.

Interes të veçantë kanë për historinë e letërsisë shqipe, kërkimet për veprimtarinë mendore në shekullin e XVIII të qendrave si Voskopoja, Vithkuqi, Berati, Korça etj., e sidomos punimet mbi Teodor Kavaliotin, Dhanil Haxhinë, Kostë Xhehanin, Kostë Beratin etj., ku, përveç shfrytëzimit të letërsisë shkencore përkatëse, janë paraqitur edhe shumë të dhëna të reja e mendime që janë frut hulumtimesh vetiake shumëvjeçare. Meriton të përmendet në mënyrë të veçantë monografia e gjerë në dorëshkrim «Protopapa Theodor Nastas Kavalioti — skolarku i Akademisë së Re të Voskopojës 1718-1789». Të dhëna me interes për historinë e letërsisë së Rilindjes janë grumbulluar në kumtimet e punimet mbi Naum Veqilharxhin, Thimi Mitkon, Thimi Krein, Jani Vreton, etj. Ilo Mitkë Qafëzezi përgatiti edhe botime të reja të leksikëve të Kavaliotit, Danilit, M. Bocarit etj., dha kontribute për historinë e gjuhësisë shqiptare me vënien në dukje të punës së Efstrat Vithkuqarit, të Kostë Xhehanit, të përpjekjeve për letrarizim të shqipes në kohë të Ali Pashës etj.

Me interes është edhe kontributi i tij në studimin e monumenteve letrare-gjuhësore arumune të Shqipërisë. Që më 1940 në një gazetë të Tiranës ai kumtonte mbi një dorëshkrim të vjetër arumun «Rreth dorëshkrimit dako-rumun të Bibliotekës kombëtare të Tiranës». Këtë tekst ai e transkripto i më vonë, e shoqëroi me shënime. Ai u botua më 1962 nga Akademia e Shkencave e Republikës Popullore të Rumanisë, shoqëruar me një studim të një dijetari rumun.

Puna vetmohuese e këtij lavruesi të pasionuar të studimeve shqiptare është vlerësuar lart nga Partia jonë e Punës dhe Qeveria e Republikës sonë Popullore. Atij i qe dhënë titulli Bashkëpunëtor i vjetër shkencor dhe grada «Kandidat i Shkencave Filologjike». Më 1953, me rastin e 50-vjetorit të veprimtarisë së tij arësimore-kërkimore, ai u nderua me dekoratën «Urdhëri i Punës i klasit të II» dhe më 1957, me rastin e 45-vjetorit të Shpalljes së pavarësisë me dekoratën «Urdhëri i Lirisë i klasit të III».

M. Domi.

JUSTIN RROTA

(17-II-1889 — 20-XII-1964)

Në muajin dhjetor vdiq në Shkodër në moshën shtatëdhjetëepesëvjeçare Justin Rrota, lavruesi i zellshëm i studimeve gjuhësore e letrare shqiptare. Me dashuri të madhe për gjuhën e letërsinë shqipe, ai dha mësimin e tyre për më se 25 vjet në shkollë të mësimi dhe punoi plot pesëdhjet vjet për to duke hartuar tekste e studime.

Shkroi ndër revista, me emrin e tij a pseudonimet Iris, Pater Ndou e Viator, tregime, artikuj e studime gjuhësore e letrare.

Justin Rrota u ka dhënë një kontribut të mirë historiografisë sonë letrare dhe studimeve gramatikore, në mënyrë të veçantë për letërsinë e vjetër dhe sintaksën.

Është ndër të parët që mendon për t'i dhënë shkollës së mesme tekstet e nevojshme. Më 1925 botoi në Shkodër «Letratyra shqype», stilistikë e teori e përgjithëshme e letërsisë në pjesën e parë, dhe histori e letërsisë shqipe me antologji në pjesën e dytë. Është i pari tekst i historisë së letërsisë shqipe i botuar shqip. Pjesën e parë në një formë më të zgjeruar e botoi për së dyti më 1934.

Merita të mëdha ka Justin Rrota në gjurmimin e botimin e autorëve tonë të vjetër. Ai qe një nga pionierët e studimit të tyre, që bëri shumë për t'i njohur ata dhe veprën e tyre në një rreth sa më të gjerë studjuesish. Solli i pari në Shqipëri kopje fotografike të Mesharit të Gjon Buzukut, Transkriptoi pjesë të zgjedhura nga autorët tanë të vjetër dhe i botoi me shënime e komente e studime hyrëse, si «Shkrimtari ma i vjetër i italo-shqyptarëve D. Lukë Matranga» (1592) (Shkodër 1931, 1939); «Monumenti më i vjetër i gjuhës shqype D. Gjon Buzuku», (Shkodër 1930, 1938). Te Gjon Buzuku ai u kthye edhe në vitet e fundit, duke botuar më 1955, me rastin e përkujtimit të 500 vjetorit të botimit të librit të tij, një artikull kujtimesh në revistën «Nëndori» dhe një studim që sjell elemente me interes mbi shumë çështje të veprës së parë të botuar shqip, «Hulumtime dhe shenjime mbi Gjon Buzukun» (në «Buletin për Shkencat Shoqërore» 1955, nr.3). Transkriptime të autorëve tanë të vjetër ai dha edhe në monografinë e tij «Për historin e alfabetit shqyp» (1936). Në tekstin «Shkrimtarët shqiptarë» pjesa I (1941) Justin Rrota shkroi pjesën më të madhe të kapitujve mbi letërsinë e vjetër e pikërisht «Dokumentat e para të gjuhës shqipe», «Shkrimtarë të vjetër të veriut: Buzuku, — Budi, — Bardhi, — Bogdani, — Kuvendi i Arbënit,» dhe ndër shkrimtarët arbëreshë «Matranga» «Variboba».

Studimeve gramatikore të shqipes Justin Rrota u dha kontribute me vlerë me artikujt e studimet e tij botuar në revista e sidomos me tekstin e tij të Sintaksës. Ndër artikujt e studimet e veçanta mund të përmendim: «Rreth gramatologjisë shqype», «Rreth problemit të gjuhës letrare», «Rreth lavrimit të gjuhës», «Vrejtje pas vretjesh». Kontribut i dha ai edhe morfologjisë e sintaksës historike të shqipes, sidomos me studimin «Analizimi i rasave t'emnit e zhvillimi historik i tynve» (1931). Ndër të tjera, ai solli aty materiale nga autorët tanë të vjetër që ndriçojnë historinë e rrjedhës e të përdorimit të saj në shqipet dhe parashtrori një tezë të re mbi të ashtuquajturën trajtë të vendores me -t prejardhjen e saj. Ndërsa Pedersenit e shpjegoi atë si një trajtë të kallëzores formuar me shtimin enklitit të nyjës-t, J. Rrota e quajti si një trajtë të rrjedhës së shquar që ose është ruajtur ose ka pasur modifikime me errësim të zanores së temës para nyjes ose me rënje fare të saj. Të njëjtën tezë mbrofti më vonë edhe gjuhëtari arbëresh Marco La Piana.

Rëndësi të veçantë ka në historinë e studimit të sintaksës shqipe teksti i punuar nga J. Rrota për kursin e ulët të shkollës së mesme «Sintaksi i shqipes» (1942,1944), frut i një pune të gjatë mësimore dhe i një njohjeje të mirë të gjuhës shqipe. Mund të themi se teksti shënoi një hap përpara nga disa anë. Së pari nga mbështetja e fuqishme në gjuhën e shkrimtarëve më të mirë dhe në gjuhën e gjallë popullore, së dyti nga zgjerimi i horizontit të fakteve sintaktike të shqipes me përfshirjen e mjaft materialeve e ndërtimeve të papërfshira në tekstet e mëparëshme dhe së treti nga trajtimi i ri i mjaft çështjeve.

Vitet e fundit ai përmbledhi shënimet e vëzhgimet e ndryshme që kishte mbledhur gjatë studimeve të tija për fakte të ndryshme morfologjike dhe hartoi një morfologji të gjuhës shqipe. Me të dhe me leksikonun, fonetikën që ai punoi, të cilave u shtoi tekstin e tij të sintaksës, ai deshë të japë një libër të plotë të gjuhës shqipe.

Justin Rrota la shembullin e një studjuesi të palodhur e të pasionuar që punoi një jetë të tërë në heshtje e me rezultate jo të parëndësishme për zhvillimin e studimeve të gjuhës e letërsisë shqipe.

M. Domi.